



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
Regulatorna Komisija Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Commission



INSTITUTI I KOSOVËS PËR KËMBANORITË E PËRBLISË  
PROJEKTI E BOKORIT I.A. JAVNE ADMINISTRACIONE  
KOSOVO/INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION

# PROCEDURA E KUFIZUAR

## Moduli i dytë i trajnimit

# Përmbledhja e trajnimit

- Historiku
- Përdorimi i procedurës se kufizuar ne BE vs Kosove
- Fazat e procedurës se kufizuar
- Afatet kohore
- Pragjet
- Format standarde
- Ngjashmëritë dhe dallimet në mes të procedurës së hapur dhe të kufizuar
- Avantazhet dhe disavantazhet e procedurës se kufizuar
- Vlerësimi i aplikacioneve
- Shërbimet e konsulences

# Qëllimi

- një kuptim të plotë dhe global **te procedurës së kufizuar të prokurimit**, duke përfshirë:
  - ✓ Kur mund të përdorim procedurën e kufizuar
  - ✓ Si funksionon kjo në praktikë
  - ✓ Rëndësia e përzgjedhjes (kualifikimit) se OE
  - ✓ Dallimi në mes të kritereve të përzgjedhjes dhe të dhënies
  - ✓ Cilat kritere e përzgjedhjes mund të aplikohen

## Qëllimi (2)

- ✓ Cili dëshmi mund ti kërkoni nga OE për të dëshmuar se janë përmbushur kriteret e përzgjedhjes
- ✓ Kur dhe ku duhet të përcaktohen kriteret e përzgjedhjes dhe dëshmitë e kërkuara
- ✓ Hapat kryesor që ju duhet të ndiqni dhe parimet kryesore që ju duhet të respektoni në procesin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë

**TEST**

# Historiku

**LPP** gjate viteve është ndryshuar disa herë dhe kështu është ndryshuar edhe dispozita lidhur me procedurën e kufizuar.

- **Ligji i pare i PP parë ka hyre në fuqi në vitin 2004, LIGJI NR. 2003/17**
- **Rregullorja Nr. 2007/20 e cila ndryshoj ligjin Nr.. 2003/17, 2007**
- **Ligji Nr. 03/L-241, 2010**
- **Ligji Nr. 04/L-042, 2011**
- **Ligji Nr. 05/L-068, 2016**

# LIGJI Nr. 2003/17, 2004

- dy lloje të procedurës së kufizuar:

	Procedura e përgjithshme e kufizuar	Procedura e veçante e kufizuar
<i>Cilat lloje të kontratave?</i>	çfarëdo <b>kontrate publike</b>	një kontrate <b>publike për shërbime komplekse intelektuale ose të konsultimit (këshillimit)</b>
<i>Kur mund të përdoret?</i>	artikulli, shërbimi ose puna në fjalë – <b>për shkak të karakterit të tyre shumë të ndërlikuar</b> - mund të furnizohen, sigurohen ose ekzekutohen nga një OE i cili posedon kapacitetin e duhur teknik, profesional ose financiar	shërbimet e dëshiruara të konsultimit – <b>për shkak të karakterit të tyre teknik, financiar, profesional ose ndonjë karakteri tjetër intelektual ose të ndërlikuar</b> – mund të furnizohen, sigurohen ose ekzekutohen vetëm nga një EO që ka ekspertizë të veçantë teknike/profesionale dhe kapacitet financiar

# LIGJI Nr. 2003/17, 2004 (2)

	Procedura e përgjithshme e kufizuar	Procedura e veçante e kufizuar
<b><i>Kush i miraton?</i></b>	<b>APP-ja</b> , pesë (5) ditë pune pasi ta ketë pranuar	<b>APP-ja</b> , pesë (5) ditë pune pasi ta ketë pranuar
<b><i>Numri minimal i OE?</i></b>	<b>3</b> kërkesa për pjesëmarrje <b>3</b> tenderë të përgjegjshëm	<b>3</b> kërkesa për pjesëmarrje <b>3</b> tenderë të përgjegjshëm
<b><i>Revokim nëse me pak se 3?</i></b>	<b>KRPP</b>	<b>KRPP</b>
<b><i>Shqyrtim i vendimit të KRPP-se?</i></b>	<b>N/A</b>	<b>N/A</b>



# Rregullorja Nr. 2007/20, 2007

	<b>bashkoj te dy procedurat</b>
	<b>Procedura e kufizuar</b>
<b><i>Cilat lloje te kontratave?</i></b>	<b>çfarëdo kontrate publike</b>
<b><i>Kur mund te përdoret?</i></b>	<b>artikulli, shërbimi ose puna në fjalë – për shkak të karakterit të tyre shumë të ndërlikuar - mund të furnizohen, sigurohen ose ekzekutohen nga një OE i cili posedon kapacitetin e duhur teknik, profesional ose financiar</b>
<b><i>Kush i miraton?</i></b>	<b>Jo APP, Konstatimi me shkrim nga ZP</b>
<b><i>Numri minimal i OE?</i></b>	<b>3 kërkesa për pjesëmarrje 3 tenderë të përgjegjshëm</b>
<b><i>Revokim nëse me pak se 3?</i></b>	<b>APP</b>
<b><i>Shqyrtim i vendimit te APP-se?</i></b>	<b>OSHP</b>

# Ligji nr. 03/L-241, 2010

	bashkoj te dy procedurat
	Procedura e kufizuar
<i>Cilat lloje te kontratave?</i>	çfarëdo kontrate publike
<i>Kur mund te përdoret?</i>	Zgjidhje e lire
<i>Kush i miraton?</i>	Autoriteti Kontraktues
<i>Numri minimal i OE?</i>	2 kërkesa për pjesëmarrje 2 tenderë të përgjegjshëm
<i>Revokim nëse me pak se 2?</i>	AK
<i>Shqyrtimi i vendimit?</i>	Jo, megjithatë KRPP duhet te njoftohet

E njëjta dispozite ishte ne Ligji Nr. 04/L-042 i vitit 2011, neni 33

# Ligji nr. 05/L-068, 2016

	<b>Procedura e kufizuar</b>
<b><i>Cilat lloje te kontratave?</i></b>	<b>çfarëdo kontrate publike</b>
<b><i>Kur mund te përdoret?</i></b>	Zgjidhje e lire
<b><i>Kush i miraton?</i></b>	Autoriteti Kontraktues
<b><i>Numri minimal i OE?</i></b>	<b>1 kërkesë për pjesëmarrje 1 tenderë të përgjegjshëm</b>
<b><i>Revokim nëse me pak se 2?</i></b>	Jo
<b><i>Shqyrtimi i vendimit?</i></b>	Jo

Plotësim/ndryshimet e bëra në LPP Nr. 04/L-042

## Shfrytëzimi i procedurës së kufizuar në shtetet anëtare të BE-ës vs Kosovo

Viti	përqindja	Konkludimet e studimit
2006	11%	<ul style="list-style-type: none"><li>• Mesatarja <b>9%</b> në bazë të numrit të njoftimeve për kontratë</li><li>• Mesatarja ndryshon në <b>23%</b> nëse marrim parasysh vlerën</li><li>• Përdoret për <b>kontrata me vlerë të mëdha</b></li><li>• <b>Tërheq një numër</b> të madh të OE</li><li>• <b>Nevojitet me shumë kohë</b>, 2 faza</li><li>• <b>Shpenzime me të larta administrative</b> për AK</li><li>• Përdoret kryesisht për <b>kontratat për shërbime</b></li></ul>
2007	10%	
2008	9%	
2009	8%	
2010	7%	

## Shfrytëzimi i procedurës së kufizuar në shtetet anëtare të BE-ës vs Kosovo (2)

Viti	përqindja	Arsyeja
2010	0%	<ul style="list-style-type: none"><li>• <b>Mungesa e dokumenteve standard</b> për procedure të kufizuara – në dispozicion vetëm në vitin 2012</li><li>• <b>Mungesa e trajnimit të zyrtarëve të prokurimit</b> – jo të familjarizuar me procedurën e kufizuar.</li></ul>
2011	1.35%	
2012	0%	
2013	0%	
2014	0.07%	

***Çka është procedura e kufizuar?***

***Kush e ka përdorur?***

# ***Çka është procedura e kufizuar?***

6 lloje te ndryshme te procedurave:

1. Procedura e hapur
2. Procedura e kufizuar
3. Procedura konkurruese me negociata
4. Procedura e negociuar pa publikimit te njoftimit për kontrate
5. Procedura e kuotimit te çmimit
6. Procedura për kontrata me vlere minimale

# ***Çka është procedura e kufizuar? (2)***

**3** procedurat **kryesore konkurruese** janë:

1. Procedura e hapur
- 2. Procedura e kufizuar**
3. Procedura konkurruese me negociata
- 4. Procedura e kuotimit te çmimit**

***Pse?***



## ***Çka është procedura e kufizuar? (3)***

- Procedura e Kufizuar është një **procedure konkurruese me dy faza**
  - ku vetëm ata OE të cilët i plotësojnë kërkesat minimale, në lidhje me **aftësinë profesionale apo teknike, përvojës dhe ekspertizës dhe kapaciteteve financiare për të kryer një projekt**
  - ftohen në tender
- mund te përdoret **për pune, mallra dhe shërbime**
- nuk ka nevojë që të **përmbushet ndonjë kusht i veçante.**

## Çka është procedura e kufizuar? (4)

- faza e pare e njohur si faza e Para-kualifikimit, ku
  - të gjithë OE ftohen t'i dorëzojnë kërkesat që të marrin pjesë ne procedurë; dhe
  - AK zgjedh OE të cilët i plotësojnë nivelet minimale të kriterëve të përzgjedhjes të specifikuara në njoftimin e kontratës.
- Kjo fazë përdoret për të vlerësuar aftësinë financiare, teknike dhe / ose profesionale dhe kapacitetin e OE.
- Kjo nuk ka të bëjë me mënyrën se si OE do të përmbushin kërkesën (do te thotë, nuk pyet se si ju planifikoni të përmbushni kontratën).

## ***Çka është procedura e kufizuar? (5)***

- faza e dytë është **Faza e dhënies së kontratës**, ku
  - **vetëm Operatorët e zgjedhur Ekonomik** lejohen të tenderojnë për kontratën.
- Autoriteti Kontraktues fton Operatorët e zgjedhur Ekonomik t'i dorëzojnë tenderët dhe i vlerëson tenderët duke përdorur kriteret e dhënies të specifikuara në ftesën për tenderim.

***Fazat e procedurës se kufizuar***

## **Fazat e procedurës se kufizuar**

- 1. Publikimi i njoftimit për kontrate**
- 2. Dërgesa e Dokumentit Para-kualifikues**
- 3. Pranimi dhe hapja e kërkesave për pjesëmarrje**
- 4. Procedura për shqyrtimin e kërkesave për pjesëmarrje – faza e parë**
- 5. Ftesa për tenderim**
- 6. Pranimi i tenderëve. Hapja e tenderit. Procedura për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Dhënia dhe nënshkrimi i kontratës – faza e dytë**

## Publikimi i njoftimit për kontrate

- Procedura e kufizuar **fillon** me **publikimin** e një njoftimi të kontratës
- Publikimi **në fillim të aktivitetit të prokurimit** **shënon fillimin zyrtar të procesit të prokurimit.**
- AK **duhet të shfrytëzojë formën standarde** dhe të dërgojë këtë formë në KRPP për publikim.
- **Si hap i parë, kërkesat e AK përcaktohen në njoftimin e kontratës**
- Në njoftimin e kontratës, **AK do të specifikojë kriteret minimale të përzgjedhjes** (kërkesat për përshtatshmëri, përshtatshmërinë profesionale, gjendjen ekonomike dhe financiare, aftësitë teknike dhe / ose profesionale dhe çdo Standard për Sigurimin e Cilësisë), **të cilat operatorët e interesuar ekonomik duhet t'i përmbushin në mënyrë që të bëhen të para-kualifikuar**

## Publikimi i njoftimit për kontrate (2)

- te gjithë operatorët ekonomik të cilët përmbushin kriteret minimale të përzgjedhjes kualifikohen dhe ftohen që të dorëzojnë një tender, në rast se numri i operatorëve ekonomik të cilët përmbushin kriteret minimale të përzgjedhjes është **me i vogël se 6**.
- Nëse numri i kandidatëve të përzgjedhur është **me shume se 6** AK duhet që **ti rivlerësoj aplikacionet** në mënyrë që të **identifikoj 6 aplikacionet me të mira** për procedurën e tenderimit.
- Prandaj **faktorët** të cilët do të merren në konsideratë gjatë këtij **rishqyrtimi të aplikacioneve** duhet të **përcaktohen në Njoftimin për kontrate**.

## Ekstarti nga forma standard e Njoftimit për kontratë

### IV.1.1) Lloji I procedurës

E hapur

E Kufizuar

Konkurruese me negociatë

### IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo e negociuar)

Në bazë të aplikacioneve të pranuar, së paku 1 dhe më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të merren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:



## **Shembull**

***Shih bashkangjitur Njoftime te  
ndryshme për kontrate te  
plotësuara***

## Dërgesa e Dokumentit Para-kualifikues

- OE që dëshirojnë të marrin pjesë në proces dhe të dorëzojnë tenderin kërkohet që të informojnë **AK me anë të një kërkesë për pjesëmarrje.**
- Dokumenti i parakualifikimit, i prodhuar nga Autoriteti Kontraktues duke përdorur formën standarde B33, do tu dërgohet apo dorëzohet operatorëve ekonomik **jo më vonë se 3 ditë** pas pranimit të kërkesës së tillë.

## Dërgesa e Dokumentit Para-kualifikues (2)

- Dokumenti i parakualifikimit përmban:
  - Fushëveprimin e projektit
  - Pranueshmërine dhe kërkesat për pjesëmarrje
  - Orarin e parashikuar
  - Kriteret e vlerësimit dhe përzgjedhjes
  - Proceduren dhe mënyrën e paraqitjes së kërkesës për pjesëmarrje
  - Formularin e paraqitjes së aplikacionit
- AK do të themelojë një "**procesverbal te kërkesave për parakualifikim**" dhe do të paraqes **ne te emrat e OE**

## Pranimi dhe hapja e kërkesave për pjesëmarrje

- Operatorët ekonomik ofrojnë informacion për përzgjedhje të AK, siç kërkohet në publikim.
- Kërkesat për pjesëmarrje të pranuar me kohë duhet të regjistrohen në "**Procesverbali për dorëzimin e Kërkesave për pjesëmarrje**".
- Kërkesat për pjesëmarrje të cilat dorëzohen pas skadimit të afatit kohor për dorëzimin e Kërkesave për pjesëmarrje, do të refuzohen ose zarfet e pranuar do **mbahen pa hapur** me qëllim që t'i kthehen dërguesit menjëherë
- Kërkesat e pranuar me kohë për pjesëmarrje **do të hapen nga AK menjëherë** pas skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesave.
- **Nuk do të ketë takim publik për hapje**

## **Pranimi dhe hapja e kërkesave për pjesëmarrje (2)**

- Ne rast se pranohet vetëm **1 kërkesë për pjesëmarrje**
  - AK mund **te vazhdoj me kërkesën e pranuar, dhe**
  - **Te mos e njoftoj KRPP.**
- **nuk është praktike e mire qe te vazhdohet me një!!!**
  - **Direktiva e BE-se - numri minimal 5?**

## Procedura për shqyrtimin e kërkesave për pjesëmarrje – faza e parë

- Lista e ngushte e kandidatëve duhet të kryhet sipas
  - rregullave jo-diskriminuese
  - transparente dhe
  - kritereve të bëra të njohura për kandidatët.
- AK vlerëson informacionin e përzgjedhjes kundër kritereve të përzgjedhjes për të OE që janë të kualifikuar për të kryer kontratën.
- **Si masë fillestare**, AK do të verifikojë nëse kërkesat përmbushin **kushtet formale**
- **Vetëm kërkesat që plotësojnë** kushtet në lidhje me **përgjegjësinë formale**, do të vlerësohen nga AK.

## Procedura për shqyrtimin e kërkesave për pjesëmarrje – faza e parë (2)

- Një kandidat nuk do të diskualifikohet, përjashtohet, apo eliminohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kushti ose kriteri që nuk është i cekur.
- Të gjithë kandidatët te cilët
  - janë të përshtatshëm dhe
  - i plotësojnë kërkesat minimale të kualifikimit, do të konsiderohen të para-kualifikuar dhe të përzgjedhur për të marrë një ftesë për tender, përveç nëse numri i kandidatëve të tillë kalon numrin gjashtë (6).
- Nëse numri i kandidatëve është më i madh se maksimumi prej 6, pikat e forta dhe dobësitë relative të aplikacioneve të këtyre kandidatëve duhet të rishqyrtohen.
- Gjatë rishqyrtimit, AKdo të marrë në konsideratë për rishqyrtim vetëm faktorët e publikuar në Njoftimin e Kontratës për ri-vlerësim.

## Ftesa për tenderim

- **Hapi i dytë** përfshin dorëzimin e specifikimeve të plota dhe dokumentet e tenderit vetëm tek të para-kualifikuarit.
- Kandidatët e para-kualifikuar do të ftohen për tenderim në të njëjtën kohë.
- Dosjes së tenderit duhet të bashkëngjitet ftesa për tender, përveç nëse dosja e tenderit është vënë në dispozicion në mënyrë elektronike - *referencë se nga ku mund të shkarkohet duhet të përcaktohet në Ftesë.*



## Ftesa për tenderim (2)

- Dokumentet e tenderit të fazës së tenderimit kanë të njëjtat pjesë të dokumenteve të tenderit si në rastin e procedurës së hapur.
- Megjithatë, dallimet e mëposhtme duhet të theksohen:
  - Udhëzimet për Operatorët Ekonomik **përmbajnë vetëm informacion për fazën e dhënies së kontratës**, pasi që tashme faza e përzgjedhjes është përfunduar.
  - Dokumentet e tenderit i dërgohen **vetëm Operatorëve Ekonomik te parakualifikuar**.

**Pranimi i tenderëve. Hapja e tenderit. Procedura për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Dhënia dhe nënshkrimi i kontratës – faza e dytë**

- **OE dorëzojnë tenderë brenda afateve kohore të përcaktuara** nga autoriteti kontraktues.
- Procedura **për pranimin e tenderëve** është e njëjtë si në procedurën e hapur.
- Procedura **e hapjes së tenderit** është e njëjtë si në procedurën e hapur.
- **Procedura e vlerësimit** ne thelb përfshin dy faza;
  - Se pari një vlerësim i përgjegjshmërisë formale të tenderëve; dhe pastaj
  - vlerësimi teknik i tenderit. (*njëjtë si në procedurën e hapur*)
- **Procedura e dhënies së kontratës** është e njëjtë si në procedurën e hapur.

## Afatet Kohore

Për të caktuar afatet kohore, AK duhet të merr parasysh kompleksitetin e kontratës dhe kohës së kërkuar për përgatitjen e tenderëve.

**Afatet kohore do të kalkulohen në datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose në datën kur të gjitha ftesat për dorëzim të tenderit dërgohen.**

	<i>Procedura</i>
	<i>E kufizuar</i>
<i>Me vlerë të madhe</i>	<i>20 ditë pranimit të kërkesave 40 ditë pranimit të tenderëve</i>
<i>Me vlerë të mesme</i>	<i>15 ditë pranimit të kërkesave 20 ditë pranimit të tenderëve</i>

## Afatet Kohore (2)

➤ Nëse Njoftim Paraprak\* - qe ka për qëllim një kontrate me vlere te madhe e **cila ka qene lende e këtij njoftimi**

➤ vetëm nëse data e publikimit të njoftimit indikativ ka ndodhur jo më pak se **40 ditë** dhe jo më shumë se **12 muaj** paraprakisht datës së publikimi:

	<i>Procedura</i>
	<i>E kufizuar</i>
<i>Me vlerë të madhe</i>	<i>20 ditë pranimi i kërkesave</i> <i>24 ditë pranimi i tenderëve</i>

## Afatet Kohore (3)

### Afate kohore të përshpejtuara

	<i>Procedura</i>
	<i>E kufizuar</i>
<i>Me vlerë të madhe</i>	<i>15 ditë pranimit të kërkesave 10 ditë pranimit të tenderëve</i>
<i>Me vlerë të mesme</i>	<i>15 ditë pranimit të kërkesave 10 ditë pranimit të tenderëve</i>

# Pragjet

## kontrata që kanë një vlerë prej më shumë se 10 000 euro

<i>VLERË E PARASHIKUAR</i>	Furnizim & Sherbime	Pune
<i>VLERË TË MADHE</i>	$\geq 125,000 \text{ €}$	$\geq 500,000 \text{ €}$
<i>VLERË TË MESME</i>	$< 125,000 \text{ €}$ $\geq 10,000 \text{ €}$	$< 500,000 \text{ €}$ $\geq 10,000 \text{ €}$

# kontratë kornizë

- Një kontratë kornizë mund të themelohet edhe nëpërmjet përdorimit të procedurës së kufizuar.
- Ka pasur një keqkuptim në lidhje me:
  - parakualifikimin e OE
  - themelimin e kontratës publike kornizë me disa operatorë ekonomikë (mini-konkurrencë)
- duke deklaruar se ato janë të njëjta pasi qe në të dy rastet:
  - ju kualifikoni OE; dhe
  - në të dy rastet ju ftoni vetëm OE të kualifikuar të dorëzojnë tenderin.

## kontratë kornizë (2)

- **dallimi** është se kur:


- kur **themeloni një listë të OE të kualifikuar**, OE në mënyrë që të jenë të kualifikuar, **duhet të paraqesin vetëm dëshmitë e dokumentuara për kërkesat e përzgjedhjes (sipas nenit 65, 66, 68 dhe 69)**

- ndërsa kur **themeloni një marrëveshje kornizë me disa OE**, OE, në mënyrë që të bëhet palë të marrëveshjes kornize, **duhet të paraqesin jo vetëm dëshmi të dokumentuara për kërkesat e përzgjedhjes (sipas nenit 65, 66, 68 dhe 69) POR edhe një tender të përgjegjshëm** (pajtueshmëri në kushtet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e dokumenteve të tenderit).




# kontratë kornizë (3)

## Parakualifikimi



## marrëveshje kornizë



# Format standarde

Nr.		Format standard për procedurën e kufizuar
1.	B20	Dosja e Tenderit - Furnizim - Procedurë e Kufizuar
2.	B21	Dosja e Tenderit- Shërbime - Procedurë e Kufizuar
3.	B22	Dosja e Tenderit - Pune - Procedurë e Kufizuar
4.	B25	Dosja e Konkursit te projektimit - Procedurë e Kufizuar
5.	B26	Dosja e Tenderit - Shërbimet Konsulentë - Procedurë e Kufizuar
6.	B30	Dosja e Tenderit për Kontrate Kornize - Furnizim - Procedura e Kufizuar
7.	B31	Dosja e Tenderit për Kontrate Kornize - Shërbime - Procedura e Kufizuar
8.	B32	Dosja e Tenderit për Kontrate Kornize - Pune- Procedura e Kufizuar
9.	B33	Dokumenti Standard i Parakualifikimit
10.	B37	Raporti i Vlerësimit te aplikacioneve Lista e ngushte
11.	B38	Raporti i Vlerësimit te tenderëve - Procedurë e Kufizuar dhe Negociuar
12.	B40	Dokumenti Standard i Parakualifikimit për Konkursin e Projektimit
13.	B43	Letër standarde për kandidatet e pa kualifikuar
14.	B44	Letër standarde për kandidatet e kualifikuar

# NGJASHMERITE DHE DALLIMET

- Procedura e hapur – *një procedure me një faze*
- Procedura e kufizuar – *një procedure me dy faza*

Dallimi kryesor

- në procedurën e hapur me një fazë OE dorëzojnë **informacion e përzgjedhjes dhe tenderët në të njëjtën kohë.**
- Në procedurën me dy faza OE
  - ✓ se pari dorëzojnë informacionin e përzgjedhjes (**para-kualifikimi**) dhe
  - ✓ pastaj **AK fton vetëm OE** të përzgjedhur për të dorëzuar tenderët.

# NGJASHMERITE DHE DALLIMET (2)

- **dallimet në mes të dy procedurave:**

1. Në procedurën e hapur çdo OE mund të dorëzojë një tender. Në procedurën e kufizuar AK është i lejuar që të kufizoj numrin e OE që fton për tender dhe të hartojë një listë të ngushte të OE.

**Kjo do të thotë se jo të gjithë OE që kualifikohen duhet të ftohen në tender.**

2. Procedura e hapur është në përgjithësi e përshtatshme që të përdoret për blerjet rutinore dhe blerjet e drejtpërdrejta përderisa procedura e kufizuar gjithashtu mund të përdoret për blerjet rutinore dhe blerjet e drejtpërdrejta por procedura e kufizuar është veçanërisht e përshtatshme për prokurimet më komplekse dhe për blerjet jo rutinore.

# NGJASHMERITE DHE DALLIMET (3)

3. Procedura e hapur është në përgjithësi e përshtatshme qe te përdoret
- për prokurimet me rrezik të ulët
  - ku **aftësia e furnizuesit është më pak e rëndësishme ose**
  - **ku fokusi është në çmim**
- ndërsa procedura e kufizuar mund të përdoret kur **aftësia e furnizuesit është faktori kyç.**
4. Sipas procedurës së hapur, **përzgjedhja dhe dhënia zhvillohen njëra pas tjetrës**, si pjesë të të njëjtit proces, përderisa në procedurën e kufizuar **përzgjedhja dhe shpërblimi zhvillohen në dy procese krejtësisht të ndara.**

# NGJASHMERITE DHE DALLIMET (4)

- ngjashmëritë në mes të dy procedurave:
  1. Tenderët mund të vlerësohen ose në bazë të kriterit çmimi më i ulët ose në bazë të kriterit tenderi ekonomikisht më i favorshëm.
  2. Negocimi në çmim dhe aspekte të tjera themelore të cilat ka të ngjarë të shtrembërojë konkurrencën është i ndaluar.
  3. Një AK është i lirë që të zgjedhë midis procedurës së hapur dhe procedurës së kufizuar.
  4. Nuk ka kushte ligjore që duhet të përmbushen kur këto procedura përdoren.

# AVANTAZHET dhe DISAVANTAZHET

- **Avantazhet e procedurës se kufizuar:**
  1. Duke kufizuar numrin e OE që marrin pjesë në fazën e tenderit, shpenzimet e AK mund të jenë më e ulëta dhe koha e shpenzuar në vlerësim mund të jetë më e shkurtër se në procedurën e hapur.
  2. Kufizimi në numrin e ofertuesve mund të ndihmoj në shmangien e kostove të panevojshme që ndërlidhen me OE që nuk janë të përshtatshem.
  3. Kjo mund të rezultojë në më shumë operatorë të interesuar ekonomik te cilët dorëzojnë **tenderë te cilësisë më të mirë**, duke lehtësuar konkurrencën më efektive.
  4. Numri i ofertuesve është më i vogël, prandaj **interesi i OE** që të dorëzojnë tender shumë me konkurrues është shumë më i lartë dhe kështu mundësia për AK që të arrij **një vlerë më të lartë për paranë është shumë më e madhe.**

# AVANTAZHET dhe DISAVANTAZHET (2)

- **Disavantazhet e procedurës se kufizuar:**
  1. Ka më shumë potencial për korrupsion nën këtë procedurë për shkak të ushtrimit më të madhe të gjykimit, dhe mundësia e marrëveshjeve të fshehta mund të jetë më i lartë.
  2. Numri i vogël i ofertuesve tashmë të njohur (se kush janë) ofron një mundësi të madhe për marrëveshje-manipulim (në mes të operatorëve ekonomik - ofertuesve) dhe korrupsion.
  3. Afatet ligjore janë më të gjatë se për procedurën e hapur, sepse kemi të bëjmë me dy procese krejtësisht të ndara të cilat kërkojnë respektimin e afateve kohore.



# VLERESIMI I APLIKACIONEVE

• Vetëm **kriteret e përzgjedhjes të listuara** më poshtë mund të përdoren nga autoriteti kontraktues për të vendosur nëse një operator ekonomik është i kualifikuar për të kryer një kontratë të veçantë apo jo:

1. Gjendja personale e operatorëve ekonomik, **nenit 65 të LPP-së**
2. Përshtatshmëria profesionale, **neni 66 i LPP-së**
3. Gjendja ekonomike dhe financiare, **neni 68 i LPP-së**
4. Aftësia teknike dhe / ose profesionale, **neni 69 i LPP-së**

## VLERESIMI I APLIKACIONEVE (2)

• Një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit nëse:

1. Një OE **vërteton të jetë i pranueshëm** dhe
2. Një OE i tillë, **në rast që AK ka përcaktuar kërkesa minimale për kualifikim, përmbush kërkesat e tilla.**

***Kriteret e përshtatshmërisë” dhe “kërkesat minimale të kualifikimit” së bashku karakterizohen si “Kritere të Përzgjedhjes”.***

• Sipas LPP, kërkesat minimale të kualifikimit, mund të përcaktohet nga AK por kur ne flasim për procedurën e kufizuar AK duhet të vendosë kërkesat minimale të kualifikimit!!!

# Shembull

## Kërkesat:

- **Kapaciteti ekonomik dhe financiar** – Mesatarja e Qarkullimit të ofertuesit për dy (2) vitet e fundit (d.m.th. 2010 dhe 2011) duhet **të jetë se paku dyfishi i vlerës totale të ofertës së tij.**
- **Kapaciteti teknik i tenderuesit** - tenderuesi ka punuar me sukses në të paktën 2 projekte për furnizimin e "artikujve shpenzues për automjete dhe punëtori " në tri vitet e fundit (d.m.th. 2011, 2010, 2009), **me një buxhet të paktën ekuivalent me atë të ofertës së tij financiare.**

## Imagjinoni:

- OFERTA 1 – 300 000
- OFERTA 2 – 600 000
- OFERTA 3 – 900 000

## ***vazhdim...***

**Mesatarja e kërkuar e qarkullimit dhe kapacitetit teknik nuk është e barabarte për te gjitha ofertat !!!**

**Tabela me poshtë paraqet kërkesat minimale te cilat duhet te përmbushen nga secili OE dhe siç mund te shihni ato nuk janë te njëjta. Prandaj kërkesat minimale duhet domosdoshmërisht ne përcaktohen ne shifra!!!**

<b>Oferta</b>	<b>Kapaciteti ekonomik the financiar</b>	<b>Kapaciteti teknik i tenderuesit</b>
300 000	600 000	2 projekte - 300 000
600 000	120 000	2 projekte – 600 000
900 000	180 000	2 projekte – 900 000

## ***Kur konsiderohet i përgjegjshëm një Aplikacion?***

Një aplikacion konsiderohet te jete i përgjegjshëm nëse:

1. është në pajtueshmëri me **kërkesat administrative;**
2. është në pajtueshmëri me **kërkesat e përshtatshmërisë;**
3. është në pajtueshmëri me **kërkesat e përshtatshmërisë profesionale;**
4. është në pajtueshmëri me **kërkesat ekonomike/financiare; dhe**
5. është në pajtueshmëri me **kërkesat teknike dhe aftësitë profesionale;**

## ***Kur konsiderohet i përgjegjshëm një Aplikacion? (2)***

**1. Ne mënyre qe një aplikacion te konsiderohet ne pajtueshmëri me kërkesat administrative Aplikuesi duhet te dorëzoj:**

- ✓ Formularin për dorëzim te tenderit te plotësuar dhe te nënshkruar*
- ✓ Origjinalin e tenderit dhe numrin e kopjeve te kërkuara*
- ✓ Deklaratën e cila deklaron nënkontraktuesin e zgjedhur, nëse aplikohet*
- ✓ Dokumentet e kërkuara për grupin e OE, nëse aplikohet*
- ✓ Kërkesa të tjera formale/administrative, nëse ka.*

## ***Kur konsiderohet i përgjegjshëm një Aplikacion? (3)***

**2. Ne mënyre që një aplikacion të konsiderohet në pajtueshmëri me kërkesat e përshtatshmërisë Aplikuesi duhet të dorëzoj:**

*✓ Deklaratën nën Betim*

- dëshmitë lidhur me **kërkesat e përshtatshmërisë (Certifikata nga ATK, nga Gjykata etj)** duhet të kërkohen që të dorëzohen vetëm nga aplikuesit të cilët AK ka ndermend që ti ftoj që të tenderojnë.

## ***Kur konsiderohet i përgjegjshëm një Aplikacion? (4)***

**3. Ne mënyre qe një aplikacion te konsiderohet ne pajtueshmëri me kërkesat e përshtatshmërisë profesionale Aplikuesi duhet te dorëzoj:**

- ✓ Dëshminë mbi regjistrimin në regjistrin profesional, komercial dhe/apo të korporatave*
- ✓ Autorizimin, licencën apo anëtarësinë në organizatë*



## ***Kur konsiderohet i përgjegjshëm një Aplikacion? (5)***

**4. Ne mënyre qe një aplikacion te konsiderohet ne pajtueshmëri me kërkesat ekonomike/financiare Aplikuesi duhet te dorëzoj:**

- ✓ *Dëshmitë mbi kërkesat e përcaktuara nga AK p.sh.*
- ❖ Deklaratë adekuate nga një banke
- ❖ Kopje të certifikuara të një ose më shumë pasqyrave të bilancit ose pjesë të pasqyrës së bilancit,
- ❖ Kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të certifikuara nga një kompani e licencuar a auditivit me reputacion apo një auditor i licencuar i pavarur.
- ❖ Deklaratat tatimore Vjetore te dorëzuara ne ATK.

## ***Kur konsiderohet i përgjegjshëm një Aplikacion? (6)***

**5. Ne mënyre qe një aplikacion te konsiderohet ne pajtueshmëri me kërkesat teknike dhe aftësitë profesionale Aplikuesi duhet te dorëzoj:**

- ✓ *Dëshmitë mbi kërkesat e përcaktuara nga AK p.sh*
- ❖ Një listë që liston furnizimet kryesore relevante,
- ❖ CV, referencat,
- ❖ pajisjet etj

## ***Shembull***

***Shih raportin e vlerësimit te aplikacioneve te bashkangjitur***

## ***Pyetje?***

*Si të veprohet , me Grupin e operatorëve ekonomik, i cili në fazën e parë është kualifikuar dhe tani në fazën e dytë kërkon të tërhiqet një anëtar i grupit?*

## ***Përzgjedhja e Operatoreve Ekonomik***

- AK kur vendosë strategjinë e përgjithshme për përzgjedhjen e OE, duhet të përcaktojë
  - **jo vetëm kriteret e përzgjedhjes** që do të zbatohen dhe provat që duhet kërkuar, por
  - **edhe numrin e OE** që do të ftohen për tenderim siç tregohet më poshtë .
- Nëse AK ka caktuar numrin maksimal të OE që do të ftojë për tenderim (**maksimum 6**), **kjo mund të rezultojë**, në praktikë, në një situatë ku, **gjatë procesit të përzgjedhjes, numri aktual i operatorëve ekonomikë që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes është më i lartë se sa numri maksimal që do të ftohen.**

## ***Përzgjedhja e Operatoreve Ekonomik (2)***

- Kur përzgjidhen OE që do të ftohen për tenderim nga radhët e operatorëve ekonomikë të kualifikuar, AK duhet të marrë në konsideratë:

- *gjendjen e tyre financiare; ose*
- *Kapaciteti e tyre teknik.*

- Kjo analizë do të rezultojë në një **renditje relative** të OE të kualifikuar
- faktorët të cilët do të merren parasysh gjatë ri-vlerësimit **duhet të përcaktohen** në Njoftimin për kontrate

## Rast studimor

### III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

- OE duhet të ketë së paku 5 punëtor të përhershëm të cilët punojnë në fusha të ngjashme me këtë kontratë.
- OE duhet të ketë kryer me sukses **dy projekte të asistencës teknike** me një buxhet **prej së paku një milion Euro secila**, ku përqindja e punëve të kryera nga OE ishte së paku 50%.

*Dëshmia e kërkuar:*

Kopja e listës së stafit të OE e cila konfirmon se ata janë duke punuar në fushat e ngjashme me këtë kontratë

Dokumentet të cilat konfirmojnë ekzekutimin e projekteve të kërkuara në III.2.4) pika 2.

## Rast studimor (2)

### IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim *(procedurë e kufizuar)*

Në bazë të aplikacioneve të pranuar, së paku **1 dhe më së shumti 6** kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të merren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

- **Numri i projekteve relevante sipas pikës III.2.4), dhe**
- **Vlera total e punës se kryer nga OE sipas pikës III.2.4)**



## Rast studimor (3)

### OPERATORI EKONOMIK 1

#### 4 projekte

Project 1: 100.000 EUR

Project 2: 80.000 EUR

Project 3: 20.000 EUR

Project 4: 100.000 EUR

### OPERATORI EKONOMIK 2

#### 2 projekte

Project 1: 190.000 EUR

Project 2: 120.000 EUR

### OPERATORI EKONOMIK 3

#### 8 projekte

Project 1: 20.000 EUR

Project 2: 60.000 EUR

Project 3: 15.000 EUR

Project 4: 15.000 EUR

Project 5: 50.000 EUR

Project 6: 30.000 EUR

Project 7: 25.000 EUR

Project 8: 25.000 EUR

*Cili është I pari, I dyti, I treti ?*

## Shembull i mire

### "Kriteri i Kapacitetit teknik:

Përvoja: Operatorët ekonomik kanë përfunduar me sukses të paktën **dy kontrata për furnizim me kompjuterë** me një **vlere minimale prej 100,000 euro secila në dy vitet e fundit** ".

"Nëse më shumë se **gjashtë OE** plotësojnë kriteret e përzgjedhjes, të vetmit faktorë që do të merren parasysh gjatë këtij ekzaminimi janë në vijim:

- **Numri më i larte** i kontratave të përfunduara me sukses që plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik deklaruar nën a) më sipër;
- **Vlera më e lartë** e kontratave të përfunduara me sukses që plotësojnë kriterin e kapacitetit teknik deklaruar nën a) më sipër.

Shënim: se pari aplikohet (i) dhe më pas aplikohet (ii), në rast se dy ose më shumë operatorë ekonomikë kanë të njëjtin numër të kontratave të përfunduara me sukses për (i) ".

## SHERBIMET E KONSULENCES

- gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, AK duhet të vendosë:
  - ✓ **Kriteret e përzgjedhjes; dhe**
  - ✓ **Kriteret e shpërblimit**
- **Kriteret e përzgjedhjes në asnjë mënyrë** nuk mund të përdorën si kritere të dhënies së kontratës.
- AK duhet të sigurojë **që të bëje**
  - ✓ **një dallim të qartë në mes kritereve të shpërblimit dhe kritereve të përzgjedhjes** dhe
  - ✓ **se nuk ka përsëritje të këtyre dy kategorive të kritereve.**

## SHERBIMET E KONSULENCES (2)

<i>Kategoritë</i>	Kriteret e përzgjedhjes	Kriteret e shpërblimit
<i>Cilat kritere mund të përdoren?</i>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përshtatshmëria</li> <li>2. Përshtatshmëria Profesionale</li> <li>3. Gjendja ekonomike dhe financiare</li> <li>4. Kapaciteti teknik dhe profesional</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çmimi me i ulet</li> <li>2. Tenderi ekonomikisht me i favorshëm</li> </ol>
<i>Shembull</i>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Eksperienca</li> <li>2. Referenca</li> <li>3. Qarkullimi</li> <li>4. CV</li> <li>5. Pajisjet</li> </ol>	<p style="text-align: center;"><b>Nëse ÇMIMI me i ulet</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. çmimi</li> </ol> <p style="text-align: center;"><b>Nëse TEMF</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. çmimi</li> <li>2. afati i liferimit</li> <li>3. garancioni</li> <li>4. karakteristikat ambientale</li> <li>5. shpenzimet rrjedhëse</li> <li>6. shërbimet pas shitjes</li> </ol>

## SHERBIMET E KONSULENCES (3)

- Sa herë që një AK dëshiron që të **shpërblej një kontratë për të shërbime të konsulences** AK:
  - ✓ duhet të përdor **procedurën e kufizuar**; dhe
  - ✓ Përveç kriterëve për dhënie të cekura me larte, mund të përdorë **edhe kritere të tjera të shpërblimit** (p.sh. kriteret e kualifikimit).
- shërbimet e konsulencës
  - ✓ faza e parë (faza e kualifikimit) zhvillohet në të njëjtën mënyrë si për kontratat e tjera publike, por
  - ✓ pasi që në fazën e dytë (fazën e shpërblimit) EO duhet të paraqesin propozimin teknik dhe propozimin financiar në zarfe të veçanta vlerësimi kryhet veç e veç.

## SHERBIMET E KONSULENCES (4)

- AK se pari **vlerëson propozimet teknike**; dhe
- pastaj hap **propozimet financiare** vetëm te atyre propozimeve që kanë kaluar **piket minimale teknike të specifikuara**.
- Rezultati i përgjithshëm arrihet duke mbledh së bashku rezultatin e **cilësisë (propozimin teknik)** dhe rezultatin e **kostos (propozimin financiar - deri në 30 pikë)**.
- Kriteret te cilat mund te përdoren gjate vlerësimit te propozimeve teknike janë:
  - ✓ **përvoja** përkatëse;
  - ✓ cilësia e **metodologjisë së propozuar**;
  - ✓ **kualifikimet e stafit kryesor të propozuar**.

## SHERBIMET E KONSULENCES (5)

**shembull:**

**Tm piket me te larta te propozimit teknik**  
**Fm çmimi me i ulet**

Kompani e konsulencës	Piket totale TP	Piket totale TP <i>St</i> <i>= 100xT/T</i> <i>m x 90%</i>	Çmimi nga FP	Piket totale FP <i>Sf</i> <i>= 100xFm/ F x 10%</i>	Piket totale TP+FP	Renditja
A	86	77.4	210.000	7.61	85.01	3
B	91	81.9	230.000	6.95	88.85	2
C	73	65.7	160.000	10	75.7	4
D	94	90	380.000	4.21	94.21	<b>1</b>

## SHERBIMET E KONSULENCES (6)

- *mund të vërehet se **kriteret e kualifikimit** mund të përdoren si kriteret për dhënie për shërbimet e konsulencës,*
- *por AK duhet të siguroj që nuk ka përsëritje midis*
  - *kritereve të përdorura gjatë fazës së kualifikimit dhe*
  - *kritereve të përdorura për propozimin teknik.*
- Kriteret e përdorura gjatë **fazës së kualifikimit** **ndërlidhen me profilin e kompanisë**; ndërsa
- Kriteret e përdorura për **vlerësimin e propozimeve teknike** **ndërlidhen me kontratën** (se si operatorët ekonomik do të përmbushin kërkesën)



# Shembull i mire

## Parakualifikimi

1) Gjendja ekonomike dhe financiare e kandidatit:

✓ Qarkullimi vjetor i kandidatit **ne secilin nga 3 vitet e fundit 2009, 2010, 2011 duhet te jete se paku 2 000 000 EUR.**

2) Kapaciteti profesional i kandidatit:

✓ Kandidati duhet të ketë aktualisht dhe mesatarisht gjatë 3 viteve të fundit, 2010, 2011, 2012 të paktën **6 persona të stafit të përhershëm** të punësuar në fushat që lidhen me këtë kontratë.

3) Kapaciteti teknik i kandidatit:

✓ kandidati ka përfunduar me sukses gjatë 3 viteve të fundit (deri në afatin e fundit për dorëzimin e aplikacioneve) **të paktën 3 projekte që mbulojnë fushat e mëposhtme te specializimit: prokurimi publik**

## **vazhdim ...**

### **Propozimi teknik (80 pike)**

#### **Organizimi dhe metodologjia**

Shpjegimi	20
Strategjia	20
Orari i aktiviteve	10
<b>Total</b>	<b>50 pike</b>

#### **Eksperti Kyç 1** **30 pike**

Kualifikimet dhe aftësitë	5
Përvoja e përgjithshme profesionale	10
Përvoja specifike profesionale	15

#### **Eksperti Kyç 2** **20 pike**

Kualifikimet dhe aftësitë	5
Përvoja e përgjithshme profesionale	7
Përvoja specifike profesionale	8
<b>Total</b>	<b>50 pike</b>

**TEST**

**Pyetje???**

**Ju faleminderit për vëmendje!**